

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ			
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRATIVË OSOBILIT			
Dalese / Izlazne Date / Data: 09 / 08 / 2025			
Nr.Orgv Org.jed.	01	Nr.Prot. Br.Prot.	294
		Nr.Faqeve. Br.Strana.	2
Ferizaj - Uroševac			



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

Tel: 038/200-46002

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me personelin shëndetësor të QKMF dhe QMF-ve në Komunën e Ferizajt

Me datën 23 korrik 2025 është mbajtur dëgjimi i peste buxhetor me personelin shëndetësor të QKMF dhe QMF-ve në Komunën e Ferizajt, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal për vitin 2026.

Hapjen e këtij takimi e ka bërë drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Dr. Kemajl Emini, i cili theksoi rëndësinë e këtyre dëgjimeve, duke i cilësuar si mekanizma të nevojshëm për identifikimin dhe trajtimin e çështjeve me të cilat përballen punonjësit shëndetësorë.

“Këto takime kanë rëndësi shumë të madhe, me vet faktin që po diskutohen dhe trajtohen tema të ndryshme në mënyrë që të vijmë deri tek zgjidhja e problemeve. Kontributi juaj është i domosdoshëm për të ndërtuar një sistem shëndetësor më të mirë për qytetarët tanë,” u shpreh Dr. Emini.

Pas fjalës hyrëse të drejtorit, fjala ju kaloi të pranishmëve.

Selvije Bislimi- inferemere në Qendrën 2 të Mjekësisë Familjare në Ferizaj

- Ka kërkuar që të shtohet stafi punues, për shkak se ka mungesë shumë të madhe të infermiereve.

Agron Selmani-Farmacistë



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERZIAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAÇELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

- Ka kërkuar që të bëhet diçka konkrete në lidhje me menaxhimin e mbeturinave farmaceutike, të bëhet një pikë grumbulluese e tyre.
- Të ndahet një buxhet i veçantë për farmacitë buxhet emergjentë.

Driton Krasniqi-Stomatolog

- Kërkoi shtim të stafit, duke theksuar pamundësinë për të funksionuar në mënyrë efikase me numrin aktual të punonjësve.

Xhevdet Haxhidema-

- Se me hapjen e Qendrës së Re të Mjekësisë Familjare, një e katërtë e qytetit mbetet pa mbulim mjekësor.
- Propozoi identifikimin e një lokacioni të ri të përshtatshëm për qendër mjekësore dhe inkorporimin e tij në Planin Zhvillimor Komunal.

Gjatë këtij takimi, stafi mjekësor dhe administrativ pati mundësinë të paraqesë kërkesat dhe rekomandimet e tyre në lidhje me përmirësimin e kushteve të punës, avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe investimet e nevojshme në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore. Ata theksuan nevojën për shtim të resurseve njerëzore pra stafin e mesëm me infermierë, duke theksuar faktin se mungesa e infermierëve është evidente tek te gjitha qendrat e mjekësisë familjare në Ferizaj.

Procesmbajtëse

Shyrete Topalli-Rexhepi